Mesazh i shkurtër këshillues në prag të muajit të bekuar të Ramazanit

Muhamed ibn Sulejman el-Ulejit


بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju!

Ky është një mesazh nga Muhamed ibn Sulejman el-Ulejit, drejtuar çdo besimtari dhe besimtareje myslimane. Allahu na e lehtësoftë të gjithëve agjërimin e muajit Ramazan. Amin!

Ky është një mesazh i shkurtër këshillues, në prag të muajit të begatë të Ramazanit. E lusim Allahun, i Cili është më Bujari, që të na e mundësojë arritjen dhe përjetimin e këtij muaji, si dhe të na begatojë në të. Paraardhësit tanë të devotshëm e luteshin Allahun gjashtë muaj radhazi që t'ua mundësonte arritjen dhe përjetimin e këtij muaji të bekuar.

Fillimisht, një besimtar i mençur duhet t'i drejtohet Allahut me pendim të sinqertë për të gjitha mëkatet dhe gabimet e tij, si për shembull: përgojimi, thashethemet, mashtrimet dhe kurthet ndaj të tjerëve, shikimi i gjërave të ndaluara, mbështetja e tepruar në vetveten duke lënë pas dore mbështetjen tek Allahu, mendjemadhësia, mosbindja ndaj prindërve, sjellja e keqe dhe nervozimi pa të drejtë ndaj të afërmve, neglizhenca e namazit në xhami së bashku me komunitetin mysliman, si dhe vepra të tjera të ngjashme. Këto veprime ia mbyllin besimtarit dyert e faljes dhe mëshirës dhe dëmtojnë jetën e tij të shkurtër, pjesa më e madhe e së cilës tashmë ka kaluar.

Ti, i cili do të jesh prijës i namazfalësve në xhami gjatë namazit të teravive, për rukutë dhe sexhdet e shumta që do t'i kryesh, shpreso shpërblimin e Allahut, sepse do të ngritesh në grada të larta të Xhenetit, ti dhe ata që do të falen pas teje. Namazi i teravive përbëhet nga trembëdhjetë rekate, së bashku me namazin e vitrit. Për shekuj me radhë, paraardhësit tanë të devotshëm e kanë ndjekur këtë praktikë dhe nuk është kundërshtuar nga dijetarët islamë.

Gjithashtu, numri i rekateve të teravive nuk duhet të mendohet se kufizohet vetëm në njëmbëdhjetë. Madje, në kohën e Omer ibn el-Hatabit, radijallahu anhu, janë falur njëzet e tre rekate namaz teravie. Ai njihte më mirë se ne metodologjinë e Pejgamberit të Allahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, dhe rruga e tij ka vlerë dhe

rëndësi për t'u ndjekur, duke u bazuar në porosi profetike. Sikur ai të kishte gabuar në këtë çështje, do ta kishin kundërshtuar bashkëkohësit e tij, si: Ali ibn Ebi Talibi, Othman ibn Afani, Sad ibn Ebi Vekasi dhe të tjerë. Një praktikë të tillë e kanë ndjekur më pas edhe dijetarët tanë të ndershëm.

Secili prej nesh duhet të angazhohet me përkushtim dhe qëndrueshmëri gjatë gjithë këtij muaji, duke iu lutur Allahut për veten, familjen dhe pasardhësit e tij, për dijetarët islamë dhe për të gjithë besimtarët myslimanë.

Allahu i Lartësuar thotë:
"Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!"

I gjithë falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Shkroi: Dijetari i devotshëm dhe asket,
Muhamed ibn Sulejman el-Ulejit

Përktheu nga arabishtja:
Abdullah Avdyli

Shaban, 1447